



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 9883 prot.

Shkodër, më 03.08. 2026

VENDIM

Nr. 60, datë 29.07.2026

**MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE MASËN E SUBVENCIONIMIT TË
INTERESAVE TË KREDIVE PËR INDIVIDË/FAMILJE QË PËRFITOJNË BANESA
ME KOSTO TË ULËT ME KREDI TË LËHTËSUAR NGA SHTETI¹**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.07.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 24 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; në nenet 15, 16, 44 e vijues të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.06.2019, “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 03.07.2019, “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar; në Vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 2, datë 22.01.2020, “Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit”; në Vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 25, datë 13.09.2023, “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social”; në Urdhrin nr. 836, datë 10.07.2025, “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Shkodër”; në Vendimin nr. 144, datë 14.07.2020, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit”; në shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 15406 prot., datë 06.12.2024, dhe shkresën nr. 15406/2 prot., datë 16.01.2025, “Mbi programin për subvencionimin e interesave të kredisë”; në shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 6859 prot., datë 21.05.2025, “Mbi nivelin e të ardhurave maksimale për të përfituar nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë”; në shkresën nr. 924/2 prot., datë 17.12.2025, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, “Mbi shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së NJEF-së dhe qarqeve për vitin 2024, sipas INSTAT-it”; në Procesverbalin e Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Shkodër nr. 18422/2 prot., datë 17.07.2026, për instrumentin financiar “Subvencionimi i interesave të

kredive”, në zbatim të programit të strehimit social “Banesa me kosto të ulët”, dhe në listën e përfituesve, si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individët/familjet që përfitojnë banesa me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 35 vota

Vota Pro	35
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	30.07.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Lista e përfutuesve të instrumentit financiar “Subvencionimi i interesave të kredisë së lehtësuar nga shteti”

Nr.	Emri / Atësia / Mbiemri	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e strehimit (neni 16, shkronja “a”)	Kushtet familjare (neni 16, shkronja “b”)	Kushtet sociale (neni 16, shkronja “c”)	Të ardhurat mujore neto të familjes, në lekë	Punësimi	Kufiri maksimal i kredisë që përfiton familja
1	Armorela Armand Sufaj	2	1+1	Nuk disponon banesë	Familje njëprindërore	Vajzë nënë	67,857	Privat	3,425,400
2	Elsameda Bajram Lici	2	1+1	Nuk disponon banesë	Familje njëprindërore	Vajzë nënë	64,526	Shtet	3,425,400
3	Vilson Lekë Peshkaj	4	2+1	Nuk disponon banesë	Familje e re		113,366	Shtet	5,044,680
4	Eltion Mehdi Kollaçej	1	Garsonierë	Nuk disponon banesë	Të rinj		50,246	Privat	2,802,600
5	Ndriçim Agim Shtubina	5	3+1	Nuk disponon banesë	Familje e re		94,440	Privat	6,228,000
6	Vegi Veiz Berberi	4	2+1	Nuk disponon banesë	Familje e re		89,400	Privat	5,044,680
7	Silvester Mhill Volaj	3	2+1	Nuk disponon banesë	Familje e re		91,951	Privat	5,044,680
8	Suada Agron Qemalaj	2	1+1	Nuk disponon banesë	Familje njëprindërore		80,925	Shtet	3,425,400
9	Dashurije Ragip Hagrepi	2	1+1	Nuk disponon banesë	Familje njëprindërore		83,384	Shtet	3,425,400
10	Flora Prend Mllugja	4	2+1	Nuk disponon banesë	Familje njëprindërore	Vajzë nënë	69,801	Shtet	5,044,680
11	Besmir Bardhyl Ramadani	4	2+1	Banojnë në banesa të mbipopulluara	Familje e re		88,800	Privat	3,026,808
12	Lismal Ali Duka	6	3+1	Nuk disponon banesë	Familje e re		71,849	Privat	6,228,000
13	Ernada Shkelqim Tafili	2	1+1	Banojnë në banesa të mbipopulluara	Familje e re		65,441	Shtet	2,055,240
14	Lekë Martin Deda	4	2+1	Nuk disponon banesë		PAK	77,939	Shtet	5,044,680
15	Ilir Ahmet Nikshiqi	4	2+1	Nuk disponon banesë			115,288	Shtet	5,044,680
16	Gavril Fejgur Dibra	4	2+1	Nuk disponon banesë			113,705	Shtet	5,044,680
17	Marsel Palokë Maçi	4	2+1	Nuk disponon banesë			121,227	Privat	5,044,680
18	Erina Ali Gjeta	5	3+1	Nuk disponon banesë		PAK	50,000	Privat	6,228,000
19	Akela Përparim Lama	3	2+1	Nuk disponon banesë			88,800	Privat	5,044,680
20	Sabjel Lirim Syjavej	3	2+1	Nuk disponon banesë			83,939	Privat	5,044,680
21	Greta Isa Ulqinaku	3	2+1	Nuk disponon banesë			77,000	Privat	5,044,680
22	Suela Bahri Dibra	4	2+1	Nuk disponon banesë			98,692	Shtet	5,044,680
23	Armand Eqrem Rustemi	3	2+1	Nuk disponon banesë			79,715	Privat	5,044,680
24	Grizelda Lodovik Cirilami	5	3+1	Banojnë në banesa të mbipopulluara			119,431	Shtet	3,736,800

SEKRETARE

Sabina Danaaj

